

Ligji Nr. 02/L-12

PËR TEATRIN

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Rregullorja Nr. 2001/9 të datës 15. maj 2001, në pajtim me Kreun 5.1 (e), 9.1.26 (a) si dhe me qëllim të zhvillimit të aktivitetit teatror në Kosovë,

Miraton:

LIGJIN PËR TEATRIN

KREU I

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Ligj rregullohet funksionimi i veprimtarisë teatrore, themelimi i teatrove dhe i trupave (ansambleve) teatrore, drejtimi, menaxhimi dhe financimi i tyre, pozita e artistëve teatror dhe çështje të tjera të rëndësishme për veprimtarinë teatrore.

Përkufizimet

Neni 2

Veprimtaria teatrale e skenike (në tekstin e mëtejshëm: veprimtaria teatrale), në pajtim me këtë ligj, përkufizohet përgatitja dhe shfaqja publike e veprave dramatike.

Neni 3

Në zbatim të këtij ligji, termat vijuese kanë këto kuptime:

a. **Teatrot** janë institucione që shfaqin publikisht vepra dramatike dhe vepra të tjera skenike;

b. **Shfaqje teatrale** konsiderohet inskenimi i drejtpërdrejt ndërmjet artistit dhe spektatorit;

c. **Vepër teatrale** konsiderohet krijimi i gjallë, artistik, i një teksti, veprimi, platforme të përfunduar dhe të mundshme për t'u shfaqur drejtpërdrejt para publikut;

d. **Veprimtari teatrale** konsiderohet krijimi, prodhimi, ekzekutimi, tregtimi, shfrytëzimi dhe promovimi i veprës teatrale, zhvillimi i vlerave kombëtare dhe universale teatrale, edukimi teatror dhe shërbimet e lidhura me këtë veprimtari;

e. **Aktorë të teatrit** konsiderohen të gjithë ata individë, vepra e të cilëve është e paracaktuar që të komunikojë drejtpërdrejt me një auditor të caktuar. Aktorë të teatrit konsiderohen personat që kanë kualifikim përkatës ose në bazë të prirjeve dhe përvojës në punët teatrale gëzojnë tretmanin e artistit teatror;

f. Në pajtim me këtë ligj, artistë teatri janë: aktorët, regjisorët, dramaturgët, skenografët, kostimografët, koreografët, piktorët, disajnerët, valltarët, këngëtarët, muzikantët, disenjatorët e ndriçimit, kreatorët e efekteve dhe zërave, grimerët, parukerët, krijuesit dhe animatorët e kukullave, kompozitorët dhe të gjithë ata që kreativisht kontribuojnë në krijimin e veprës teatrale;

g. **Trupë teatrore** konsiderohet personi juridik, privat ose publik, vendor ose ndërkombëtar, i cili merr përgjegjësinë e realizimit të veprimtarisë teatrore dhe gëzon cilësinë e titullarit, përkatësisht pronarit;

h. **Projekt teatror** konsiderohet çdo ide e zhvilluar dhe e plotësuar deri në nivelin e shpjegimit të kuptueshëm, duke përfshirë të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e veprës teatrore;

i. Projekti teatror mund të jetë i sferës së prodhimit, të edukimit, të promovimit, tradicional ose alternativ, privat ose publik;

j. **Aplikim** konsiderohet kërkesa e teatrove dhe trupave teatrore për financim nga fondi publik për realizimin e një ose më shumë projekteve teatrore;

k. **Mbështetje financiare** konsiderohet masa e financimit të projektit teatror dhënë teatrove dhe trupave teatrore nga fondi publik;

l. Trupat teatrore mund të jenë të përhershme, të përkohshme, ad-hoc grupe, individuale ose kolektive.

KREU II

INSTITUCIONET E TEATRIT DHE ORGANIZIMI I TYRE

Neni 4

Teatri është i rëndësishëm që të ruaj dhe kultivojë identitetin kulturor, por edhe të dizajnojë dhe afirmojë atë në vend dhe jashtë vendit. Teatri është pjesë e pasurisë kulturore dhe artistike e Kosovës.

Neni 5

Ky ligj garanton të drejtën për shprehje dhe kreativitet të lirë artistik dhe skenik.

Neni 6

Veprimtari teatror në Kosovë kanë të drejtë të ushtrojnë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, pa dallim etnie, race e gjinie.

Neni 7

Veprimtaria teatror është me interes të veçantë për publik, prandaj investimi në këtë veprimtari dhe shfrytëzimi i fondeve publike është e drejtë legjitime. Përdorimi i fondeve publike përjashton mundësinë e ndërhyrjes në lirinë artistike.

Neni 8

Teatrot publike funksionojnë për të mirën publike dhe njihen si organizata me status të benficuar publik.

Neni 9

Veprimtaria Teatror në Kosovë zhvillohet në këto teatro:

- a. Teatri i Kosovës
- b. Teatrot profesioniste të qyteteve
- c. Teatrot e qyteteve

- d. Teatrot private
- e. Trupat teatrore
- f. Teatrot e studentëve të Artit Dramatik

Neni 10

Teatri i Kosovës dhe teatrot e tjera vazhdojnë veprimtarinë e tyre në pajtim me këtë ligj.

Neni 11

Teatrot mund të jenë në pronësi publike dhe private.

Neni 12

Në pronësi publike janë:

- a. Teatri i Kosovës
- b. Teatrot profesioniste
- c. Teatrot e qyteteve

Neni 13

Teatrot publike mund të themelohen nëse janë plotësuar kushtet materiale, teknike, të kuadrove dhe kushtet e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 14

Arsyetimin për themelimin e teatrove publike e vlerëson Ministria e Kulturës dhe organet kompetente komunale.

Neni 15

Teatrot private, trupat e përhershme dhe trupat e tjera teatrore mund të jenë në pronësi të personave juridikë dhe fizikë, (vendor apo të jashtëm.) ,nga Kosova dhe jashtë saj.

KREU III

Financimi

Neni 16

Teatri i Kosovës, teatrot profesioniste të qyteteve dhe teatrot e qyteteve janë institucione buxhetore ose gjysmë-buxhetore, që krijohen ose transformohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të këtij ligji.

Neni 17

Mjetet për punën e teatrove publike sigurohen nga:

- a. Buxheti i MKRS;
- b. Buxheti i qytetit, përkatësisht i komunës;
- c. Të hyrat vetanake, të realizuara nga veprimtaria e teatrove;
- d. testamenti, sponsorët, dhuratat dhe të hyrat tjera.

Neni 18

Mjetet për punën e teatrove private sigurohen nga:

- a. pronarët e teatrove;
- b. të hyrat vetanake, të realizuara nga veprimtaria e teatrit;
- c. mundësisht nga MKRS, si dhe nga Drejtoritë për kulturë të komunave ku vepron teatri;
- d. testamenti, sponsorët, dhe të hyrat e tjera.

Neni 19

MKRS harton politikën zhvillimore të teatrove, të cilën e aprovon Ministri.

Neni 20

Bazuar në kërkesat e projekteve vjetore të teatrove, MKRS harton për çdo vit kalendarik kriteret për mbështetjen financiare të veprimtarisë teatrore.

Neni 21

MKRS obligohet të publikoj procedurat e aplikimit për mbështetje financiare.

Neni 22

Teatrot publike obligohen që për çdo vit kalendarik të publikojnë në mjetet e informimit:

- a. Synimet e përgjithshme të politikës së repertoarit;
- b. Planin vjetor të repertoarit;
- c. Vizitat (turnetë) brenda dhe jashtë vendit.

KREU IV

TEATRI I KOSOVËS

Neni 23

Teatri i Kosovës është institucion publik i artit teatror të Kosovës me seli në Prishtinë.

Neni 24

Teatri i Kosovës është teatër që kultivon vlera të dramaturgjisë kosovare dhe asaj botërore.

Neni 25

Teatri i Kosovës duhet të ketë ansambël artistik, rezident, të përbërë nga më së paku tridhjetë (30) aktorë cilësorë, të të gjitha gjeneratave.

Neni 26

Teatri i Kosovës realizon repertoar të verifikuar artistik dhe të qëndrueshëm:

- a. së paku tri shfaqje në javë;
- b. realizon së paku pesë premiera të shfaqjeve teatrore gjatë një viti kalendarik;

Këshilli drejtues i TKK

Neni 27

Këshilli drejtues i Teatrit është organ i pavarur që mbikëqyrë punën e menaxhmentit të Teatrit të Kosovës.

Neni 28

Këshilli drejtues aprovon politikat afatgjata të zhvillimit të teatrit, duke përfshirë politikën artistike dhe strukturën udhëheqëse.

Neni 29

Këshilli drejtues është përgjegjës për sigurimin e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të objektit, si dhe sigurimin e mjeteve financiare për aktivitetet e teatrit.

Neni 30

Këshilli drejtues i Teatrit aprovon buxhetin dhe programin vjetor për teatrin, si dhe ka qasje në dokumentacionin e rregullt dhe llogarimbajtjen.

Neni 31

Këshilli drejtues zgjedh udhëheqësit e lartë ekzekutiv të teatrit me konkurs publik dhe me mandat tre vjeçar:

- a. Drejtorin e përgjithshëm dhe
- b. Drejtorin artistik .

Neni 32

Zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të TKK e miraton Ministri i Kulturës.

Neni 33

Ministria së paku një herë në vit, kërkon që llogarimbajtja e teatrit mbikëqyret nga një auditor i pavarur me kualifikime të dëshmuara. Këtë auditor e cakton Këshilli drejtues i TKK.

Anëtarësia e Këshilli drejtues i TKK

Neni 34

Këshilli duhet të ketë shtatë ose nëntë anëtarë.

Neni 35

Këshillin drejtues të Teatrit e zgjedhë MKRS. Këshilli drejtues i përgjigjet Ministrisë së Kulturës. Anëtarët e Këshillit drejtues duhet të jenë njohës të mirë të kësaj fushe.

Neni 36

Këshilli drejtues i TKK zgjidhet me mandat tre vjeçar. Anëtarët e Këshillit mund të rizgjidhen edhe për një mandat. Një e treta nga anëtarësia e Këshillit duhet të lëshojnë Këshillin në sistem rotativ, ku anëtarët që kanë shërbyer më së gjati duhet të zëvendësohen. Kohëzgjatja e shërbimit llogaritet nga data përfundimtare e zgjedhjeve të fundit.

Neni 37

Anëtarët e Këshillit nuk kanë të drejtë në kompensim për shërbimet e veta, përveç në mbulimin e shpenzimeve që bëhen gjatë kryerjes së detyrës.

Udhëheqësit Ekzekutiv

Neni 38

Teatri i Kosovës dhe teatrot tjera publike kanë dy udhëheqës të lartë ekzekutiv:

- a. Drejtori i përgjithshëm, dhe
- b. Drejtori Artistik

Neni 39

Drejtori i përgjithshëm është përgjegjës për çështjet afariste të teatrit, duke përfshirë:

- a. Përpilimin e buxhetit vjetor dhe prezantimin e tij para Këshillit për aprovim;
- b. Përgatitjen e aplikacioneve për mbështetje financiare nga burimet publike;
- c. Dorëzimin e aplikacioneve dhe propozimeve për mbështetje nga fondacionet humanitare dhe burimet e biznesit;
- d. Monitorimin e të hyrave dhe të dalave, në pajtim me buxhetin;
- e. Siguron mbarëvajtjen e punëve në teatër nëpërmjet një strukture administrative të duhur;
- f. Negocion dhe nënshkruan kontratat me të punësuarit dhe autorët e pavarur siç janë: shkrimtarët, regjisorët, etj;

- g. Negocion kontratat për vizitat (turnetë) brenda dhe jashtë vendit;
- h. Mbikëqyr marketingun dhe promovimin e teatrit;
- i. Mbikëqyr shitjen e biletave;
- j. Mbikëqyr menaxhimin efikas të ndërtesës, duke përfshirë edhe kujdesjen ndaj klientëve, përkatësisht spektatorëve;
- k. Për punët dhe detyrat e tij i përgjigjet Këshillit drejtues.

Neni 40

Drejtori Artistik në bashkëpunim me Këshillin Drejtues të Teatrit është përgjegjës për çështjet artistike të teatrit, duke përfshirë:

- a. Përpilimin e repertoarit vjetor, në pajtim me politikën artistike të aprovuar nga Këshilli;
- b. Përzgjedhjen dhe klasifikimin e projekteve teatrore nga pikëpamja cilësore e kulturore;
- c. Merr vendim vetëm pasi është njoftuar me projektin e aplikuar dhe pasi ka dëgjuar shpjegimet e aplikuesit;
- d. Drejtori artistik i propozon Këshillit miratimin e projekteve artistike;
- e. Bën propozimin e aktorëve që i bashkëngjiten ansamblit, dhe ndarjen e roleve për produksione të veçanta;

- f. Propozimin e shkrimtarëve, regjisorëve, scenografëve, disenjatorëve, etj;
- g. Mbështet zhvillimin e talentëve të rinj, në veçanti të shkrimtarëve të rinj;
- h. Bashkëpunimin me artistët ndërkombëtar të teatrit.

Aktorët dhe punëtorët tjerë të TKK-ës

Neni 41

Zgjedhja e aktorëve, punëtorëve dhe ekspertëve të tjerë të teatrit bëhet me konkurs.

Neni 42

Ansamblin e përhershëm e përzgjedh Komisioni Profesional i përbërë nga 5 anëtarë: dy prej tyre i cakton Teatri, dy themeluesi dhe një anëtar i jashtëm nga fusha e teatrit. E njëjta mënyrë e zgjedhjes bëhet në teatrot tjera publike.

Neni 43

43.1. Aktorët e ansamblit në teatrin publik themelojnë marrëdhënie pune me kontratë një vjeçare me të drejtë të ripërtëritjes së kontratës, përderisa teatri ka nevojë për të.

43.2. Personat nga paragrafi 1 i këtij neni, me të cilët nuk do të lidhet kontratë e re për punësim, njoftohen për këtë më së voni tre (3) muaj para skadimit të afatit të kontratës.

43.3. Për realizimin e programit teator (repertoarit) mund të angazhohet edhe personeli tjetër me kontratë të punës mbi veprën, në pajtim me ligjin.

Neni 44

E drejta në sigurim pensional dhe shëndetësor të personelit artistik nga radhët e artistëve teator jashtë zgjatjes së marrëdhënies së punës në teatër, përcaktohet me dispozita të veçanta në përputhshmëri me Ligjin e punës.

Neni 45

Dispozitat më të hollësishme për mënyrën dhe veçoritë e punës dhe organizimit të teatrit përcaktohen me statutin e teatrit publik.

Neni 46

Statutin e nxjerr Këshilli drejtues, kurse e miraton themeluesi.

KREU V

Teatrot tjera publike

Neni 47

Teatri mund të themelohet nëse janë plotësuar kushtet e parapara me ligj për sigurinë e vizitorëve, punëtorëve dhe ambientit rreth teatrit, si dhe kërkesave tjera të parashtruara nga themeluesi i teatrit.

Neni 48

Dispozitat e këtij ligji për administrimin e Teatrit të Kosovës aplikohen në mënyrë përkatëse edhe në organizimin dhe funksionalizimin e teatrove tjera publike.

Neni 49

Teatrot publike janë në përgjegjësi të komunave. MKRS mund të mbështes financiarisht projekt programin deri në 50% (pesëdhjetë për qind) të fondeve.

Neni 50

Teatrot profesioniste të qyteteve janë:

- a. Teatri profesionist i qytetit të Gjakovës;
- b. Teatri profesionist i qytetit të Gjilanit.
- c. Veprimtarinë e tërësishme të teatrove profesioniste të qyteteve MKRS mund t'i mbështes financiarisht mbi 50% analog me buxhetin e qytetit.

Neni 51

Teatrot profesioniste të qyteteve duhet të kenë ansambël artistik, rezident, të përbërë nga së paku njëzetë(20) aktorë cilësorë të të gjitha gjeneratave.

KREU VI

TEATROT PRIVATE

Neni 52

Teatër privat mund të formoj çdo person fizik apo juridik.

Neni 53

Për themelimin e Teatrit Privat është i nevojshëm regjistrimi si subjekt juridik pranë organeve kompetente.

Neni 54

Teatri mund të themelohet nëse janë plotësuar kushtet e parapara me ligj për sigurinë e vizitorëve, punëtorëve dhe ambientit rreth teatrit, si dhe kërkesave tjera të parashtruara nga themeluesi i teatrit.

Neni 55

Teatrot private themelohen me mjetet vetanake të personave fizikë apo juridikë, vendor ose ndërkombëtarë.

Neni 56

Teatrove private u mundësohet konkurrimi me projekte artistike për mjete financiare dhe mjete nga sponsorimet përkatëse, njësoj sikurse edhe teatrove publike.

Neni 57

Teatrot private janë të lira të kontraktojnë shërbimet e projektit, në kushtet e tregut.

Neni 58

Projektet e teatrove private mund të mbështeten financiarisht edhe nga buxheti i Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport, si dhe nga buxheti i komunës në të cilën veprojnë.

KREU VII

TRUPAT TEATRORE

Neni 59

Trupat teatrore mund të jenë të përhershme, të përkohshme, ad-hoc grupe, individuale ose kolektive.

Neni 60

Trupat teatrore kane të drejtë të konkurrojnë me projekte për mbështetje financiare pranë MKRS, dhe pranë drejtorive komunale ku ato veprojnë.

KREU VIII

QENDRAT E KULTURËS DHE ARTIT (ish- Shtëpitë e Kulturës)

Neni 61

Qendrat e Kulturës dhe Artit (ish- Shtëpitë e Kulturës) janë institucione publike që kanë kapacitet dhe infrastrukturë fizike e administrative të domosdoshme për shërbimet e prodhimit, të edukimit, të përhapjes, të promovimit dhe të shfaqjes së veprës teatrore dhe veprave të tjera artistike e kulturore.

Neni 62

Qendrat e Kulturës dhe Artit mund të emërtohen edhe në cilësinë e një arti të vetëm ose mund të mbajnë emërtime të tjera, të zgjedhura, në përputhje me funksionet dhe nevojat e këtyre qendrave.

Neni 63

Qendrat ekzistuese të kulturës dhe artit janë në pronësi publike.

Neni 64

Qendrat e Kulturës dhe Artit mbajnë të drejtën që të hyjnë në marrëdhënie kontraktore, shërbimi e bashkëpunimi me trupa teatrore dhe me persona të tjerë fizik e juridik, që ushtrojnë veprimtari artistike e kulturore për projekte të veçanta ose stinore.

Neni 65

Bashkëjetesa, nën një politikë dhe administrim të përbashkët dhe afatgjatë, ndërmjet qendrës së kulturës dhe artit nga njëra anë dhe trupave teatrore (ose të një personi tjetër juridik, privat apo publik) nga ana tjetër, bëhet me miratimin e pronarit të qendrës dhe mënyra e bashkëjetesës sanksionohet në një kontratë të posaçme mbështetur në parimet e këtij ligji.

Neni 66

Qendrat e Kulturës dhe Artit, në përputhje me ofertë-kërkesën dhe me lëvizjet e tregut negociojnë tarifat e shërbimeve, që miratohen nga organet e tyre udhëheqëse.

KREU IX

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 67

Me gjobë prej 1.000 -5.000 euro për kundërvajtje dënohen teatrot:

- a. në qoftë se nuk e ruajnë materialin e dokumentacionit dhe nuk mbajnë evidencën e punës vijuese;
- b. në qoftë se brenda afatit të parashikuar, organizimin dhe veprimtarinë e tyre nuk e harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji.

KREU X

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Mbikëqyrja e ligjshmërisë

Neni 68

Mbikëqyrjen e ligjshmërisë në punën e Teatrit të Kosovës e bënë MKRS, kurse në teatrot profesioniste të qyteteve e bëjnë MKRS dhe drejtoritë komunale të kulturës, në territorin e së cilës është selia e teatrit.

Neni 69

Ndërtesa dhe infrastruktura e Teatrit të Kosovës, si dhe ato të teatrove profesioniste të qyteteve nuk mund të tjetërsohen dhe as të jepen në përdorim, përpos në rastet kur nuk e pengojnë mbarëvajtjen e programit të teatrit. Të gjitha të hyrat që fitohen në këtë rast duhet të derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës me destinim për teatrin.

Neni 70

Teatrot kanë për detyrë të ruajnë materialin e dokumentacionit për të gjitha shfaqjet dhe të mbajnë evidencën e punës vijuese.

- a. Udhëheqësi i organit qendror të administratës kompetente për punët e kulturës do të nxjerr dispozita më të hollësishme mbi mënyrën e ruajtjes së materialit të dokumentacionit dhe mbajtjes së evidencës.
- b. Teatrot e të gjitha niveleve janë të detyruara që dokumentacionin, lëndën arkivore dhe të regjistruar ta ruajnë në përputhje me dispozitat për ruajtjen e lëndës arkivore dhe arkivat.

- c. Në rastin kur teatri e ndërpret punën, dokumentacioni, lënda arkivore dhe atë të regjistruar i dorëzohet në ruajtje arkivit kompetent.

Neni 71

Në afatin prej gjashtë muajsh, pas nxjerrjes së akteve të përgjithshme mbi organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës, Teatri i Kosovës dhe teatrot profesioniste të qyteteve reformojnë teatrot, në përputhshmëri me dispozitat e këtij ligji.

Neni 72

Deri me nxjerrjen e statuteve të teatrove publike aplikohen dispozitat e statuteve dhe të akteve të tjera të përgjithshme të teatrove ekzistuese, po që se nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 73

Prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji pushon të vlej Ligji mbi veprimtarinë teatrore dhe skenike-muzikore (Gazeta Zyrtare e Kosovës Nr. 5/79).

Neni 74

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara.

Më 8 qershor 2005

UNMIK/REG/2005/31